



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 173/14 Prot.

Tiranë, më 4/7/2013

U R D H E R

Nr. 15 datë 04/7 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë,

K O N S T A T O V A

Pranë kontrolluesit, Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë, një grup kontrolli i Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbështetur në urdhrin Nr.51, datë 11.03.2013, të Komisionerit ka zhvilluar kontrollin administrativ me objekt:

**1-Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale, sipas nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në lidhje me:**

- Transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.

Kontrolluesi, Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë, në aktivitetin e tij ka grumbulluar dhe përpunuar të dhëna personale kryesisht të kategorisë, "pacientë".

Duke marrë shkas, nga të dhënat e siguruara nëpërmjet QKR-së, grupi i kontrollit e ka parë të arsyeshme, që të verifikonte disa herë, faktin nëse ky kontrollues, e kishte aktivitetin e tij spitalor, apo jo, dhe përfundimisht është konstatuar se, aktualisht ky aktivitet është pezulluar. Nga kontaktet me përfaqësuesen e këtij kontrolluesi, znj. Arjula Cibaku, me profesionin dhe detyrën e juristit, është bërë e ditur, se ky kontrollues, për mungesë fondesh e ka pezulluar që prej dy vjetësh këtë aktivitet.

Të dhënat personale të grumbulluara klasifikohen të dhëna mbi gjëndjen shëndetësore të pacientëve, e si të tilla, këto të dhëna janë të dhëna *sensitive*, në bazë të përcaktimeve të nenit 3, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Të dhënat e pacientëve, mbaheshin në një database, database kjo që administrohej, vetëm nga një punonjëse, ajo e arkivës, dhe që vetëm ajo kishte akses në të.

Gjithashtu, mbaheshin të dhënat mjekësore në mënyrë manuale, por nëpër kartela mjekësore, të cilat klasifikohen sigurisht si të dhëna sensitive, ku konsistonin në diagnostikimin dhe ecurinë e mjekimit kronologjik të pacientëve.

Për sa i përket, transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, objekt i këtij kontrolli, ky kontrollues ashtu si dhe e përmend nuk kish si të kryente transferim të dhënash të pacientëve, pasi kish dy vjet që kish pezulluar aktivitetin, por dhe në kohën kur ushtronte aktivitetin spitalor, nuk ka kryer transferime të të dhënave të pacientëve.

Nuk konstatohet shkelje lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, apo me qëllimin, mjaftshmërinë dhe keqpërdorimin e tyre për qëllime të tjera.

Ky kontrollues, mbetet në pritje të rihapjes së aktivitetit spitalor, dhe për pasojë të dhënat e grumbulluara për pacientët, mbaheshin edhe për faktin, se pacientët, sipas nevojave të tyre kërkonin nga ky kontrollues të dhënat e tyre jo rrallëherë.

Si ne çdo praktikë të kontrollit administrativ, dhe në këtë rast është mbajtur proces verbali që daton më 20.06.2013, ku përfaqësuesja e kontrolluesit është shprehur si më poshtë:

*“Subjekti, Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë, është në pritje të sigurimit të fondeve për rihapjen e aktivitetit, objekti i tij. Nëqoftëse ky objektiv nuk realizohet brenda një periudhe 5-vjeçare nga pezullimi i aktivitetit, të dhënat e ruajtura për pacientët, do të asgjësohen”.*

- **Gjatë kontrollit administrativ u konstatua se, kontrolluesi Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë nuk ka kushte për shkelje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, sidomos për sa i përket transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, objekt i këtij urdhëri.**

Sa më sipër në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## U R D H E R O J

I-Kontrolluesi Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë, konform nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në momentin që do të rifillojë aktivitetin e tij spitalor, të bëjë njoftimin pranë Zyrës së KMDP-së.



2-Kontrolluesi Universal German Hospital Albania, SH.A Tiranë, konform nenit 5, paragrafi 1, gërma "c" të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, në rast të mosrealizimit të objektivit, për rihapjen e aktivitetit brenda një periudhe 5-vjeçare nga pezullimi i aktivitetit, ashtu si dhe vetë përfaqësuesi i kontrolluesit ka deklaruar, të asgjësojë të dhënat e pacientëve, dhe gjithashtu të verë në dijëni Zyrën e KMDP-së.

3. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

